



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.56/2016

Prishtinë, më 3.5.2016, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Të ftuar: Musa Shabani, kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), Dritan Gjonbalaj, drejtor i Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC).

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Konjuhi, Kemajl Zeqiri, Festim Kutllovci, Azem Rexhaj dhe Ramiz Krasniqi - KPM, Besnike Ukmata dhe Kushtrim Musa – AAC, Fehmi Pireva – Kuvendi i Kosovës, Fjolla Uka – KDI, Mjellma Kadriu – praktikante dhe Lumrije Murati – ZPRK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.4.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPM, për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC, për vitin 2015;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendit i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.4.2016;

Procesverbali nga mbledhja e datës 26.4.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM, për vitin 2015;

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kemi marrë një raport mjaft voluminoz, ku shihet që ky organ rregullativ ka zhvillu një aktivitet dinamik pas konstituimit. Ishte një periudhë kur nuk pati kuorum, prandaj ka qenë mjaft i ngarkuar me punë pas konstituimit...

Musa Shabani, kryesues i Bordit të KPMM-së, prezantoi anëtarët e Bordit dhe drejtorin e KPMM-së, e më pas paraqiti raportin vjetor të KPMM-së për vitin 2015. Edhe pse viti 2015 ka qenë një vit sfidues dhe i vështirë për industrinë minerare në botë, për shkak të rënies së çmimeve të metaleve në tregjet botërore, KPMM-ja përkundër kësaj ka arritur rezultate pozitive, me një tejkalim të mbledhjes së buxhetit për 11%. Gjatë vitit 2015, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është angazhuar maksimalisht për luftimin e operatorëve ilegalë, të cilët me vite po i krijojnë probleme të mëdha këtij institucioni, atyre që operojnë në mënyrë legale, ambientit dhe buxhetit të Kosovës në veçanti. Ka pasur edhe një bashkëpunim të kënaqshëm për çështjet e ndërlidhura me aktivitetin minerar, me disa nga institucionet përgjegjëse të nivelit qendror dhe të atij lokal. KPMM do të vazhdojë me intensitet edhe më të shtuar gjatë vitit 2016, që t'i përkrahë dhe mbështes në çdo aspekt të gjithë ata që merren ose pretendojnë të merren me industrinë minerare, njëkohësisht do t'i ndalojë, këshillojë dhe përmirësojë të gjitha ato që bien në kundërshtim me Ligjin dhe rregullat në fuqi për sektorin minerar. KPMM është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare, taksat dhe gjobën administrative. Në vitin 2015 janë inkasuar 30,141,403€ ose 11% më shumë se në vitin paraprak, nga Renta Minerare, nga Taksa Administrative dhe nga Gjoha Administrative. Kontribuesit më të mëdhenj në mbushjen e buxhetit janë KEK-u, Ferronikeli, Sharr Cemi dhe Guroret të cilat nxjerrin dhe përpunojnë shkëmbinj të fortë. Gjatë periudhës maj-dhjetor 2015, Bordi i KPMM-së ka mbajtur 34 takime, në të cilat janë shqyrtuar 333 kërkesa për licenca dhe leje. Për shkak të mungesës së kuoromit të Bordit të KPMM-së në vendimmarrje, në një periudhë 13 mujore, është një numër i madh i takimeve të mbajtura, respektivisht kërkesave të shqyrtuara brenda kësaj periudhe. Brenda muajit, mesatarisht, janë mbajtur 4 takime, përkatësisht janë shqyrtuar 42 kërkesa për licenca dhe leje. KPMM vetëm gjatë vitit 2015 ka pranuar gjithsej 202 kërkesa për licenca dhe leje për aktivitete të veçanta. Gjatë vitit 2015, KPMM-ja ka organizuar edhe një work shop për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, nga i cili rezultoi përgatitja e një Plan i veprimit, i cili tani është në tavolinat e Qeverisë për miratim. Sponsorues i këtij Plani të Veprimit, përveç KPMM-së ishte edhe MMPH-ja dhe MZHE-ja. Brenda vitit 2015, KPMM ka lëshuar 163 Licenca dhe Leje, ka refuzuar për mospërmbushje të kushteve për licencim 48 kërkesa për licenca dhe leje. Gjatë këtij viti janë realizuar 1749 inspektime. Nga inspektimet e aktiviteteve minerare të jashtëligjshme janë

identifikuar 73 operues ilegalë, ndaj të cilëve janë ndërmarrë masat e nevojshme të parapara për veprimtarinë ilegale në fushën e minierave. Në këtë vit janë bërë 63 kallëzime penale në Prokuroritë kompetente, në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni, për operime ilegale. Duke pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar, buxheti i aprovuar ose final i KPMM-së për vitin 2015 ishte 1,186,273.00€, përderisa i realizuar është 1,129,638.00€, ose rreth 95% e buxhetit të përgjithshëm. KPMM, parasheh që të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e detyrave dhe përgjegjësive të veta në të ardhmen përmes ngritjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi dhe objektivave të caktuara në veçanti: ndalimi i operimeve ilegale, ngritja e kualitetit të punës dhe sigurisë në punë, rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, ngritja e nivelit të shërbimeve për palë të treta, përmes ofrimit të asistencës teknike dhe profesionale nga KPMM. Si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen, z. Shabani veçoi operimet ilegale, mosharmonizimi i kornizës organizative dhe ligjore të sektorit mineral, në veçanti me Ligjin për Pyjet e Kosovës, pamundësia e implementimit të dispozitave ligjore për sekuestrim të mjeteve – makinerisë të rastet e veprimeve ilegale, sigurimin e resurseve minerale për gjeneratën e tashme dhe ruajtjen e qasjes në resurset natyrore edhe për gjeneratën e ardhshme, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis dhe komunitetet lokale, rritja e numrit të lëndëve ose rasteve nëpër gjykata, rritja e borxheve ndaj KPMM-së; çështja e përmbarimit, ekzekutimit të gjobave administrative dhe vendimeve në përgjithësi të KPMM-së dhe mungesa e një objekti të përhershëm për zyrë.

Kryetari, theksoi se ky raport ka shumë të dhëna, por raporti duhet të jetë më i përmbledhur në problemet kyçe, të cilat e ngadalësojnë punën e juaj. Keni thënë ndërtimi i një sektori modern mineral në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës, si ta ndërtojme një sektor të tillë modern mineral që i kontribuon zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik? Kosova është mjaft e pasur me resurse minerale, dhe duhet të merr mësim nga ato vende të cilat nga minierat kanë ndërtuar shoqëri prosperuese dhe ekonomi të zhvilluar. Për harmonizimin e ligjeve të bëhet evidenca e qartë se cilat ligje nuk janë të harmonizuara dhe të iniciohet në ministri, por edhe nga Komisioni Parlamentar, nëse ministria nuk fillon të harmonizojë ato ligje. Ende mbeten probleme të inkasimit, shfrytëzimit ilegal, dhe këto çështje të shqyrtohen në këtë debat.

Raif Qela, tha se raporti është mjaft i detajuar. Periudha derisa nuk ka pasur kuorum të Bordit për vendimmarrje, që nga fundi i prillit 2014, deri në maj 2015, një pjesë e operatorëve të cilëve iu ka skaduar licenca kanë pasur probleme me shfrytëzimin, dhe pyeti se si është reflektuar kjo në shfrytëzimin e pasurive minerale dhe në veçanti për Trepçën, sa ka ndikuar ajo që prodhimi i Trepçës të bjerë për shkak të mungesës së licencës, nëse vërtetë ka pasur rënie për shkak të saj?

Besim Beqaj, po ashtu raportin e konsideroi mjaft të detajuar dhe potencoi se janë tre çështje themelore që duhet t'i adresojmë. Shfrytëzimi ilegal, këtu duhet të fokusoheni shumë më shumë në bashkëpunim me organet tjera, siç dihet ligji ju mundëson që të shqiptoni gjoba respektivisht të bëni kallëzime penale, prandaj duhet një bashkëpunim më i mirë me organet e rendit dhe organet e drejtësisë në mënyrë që kjo të parandalohet. Përdorimi i zhavorrit dhe gurit është bërë problematik për rrjedhën e lumenjve, cilësinë e ujit dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Mospërputhja me lejet mjedisore të cilat i lëshon Ministria e Mjedisit, ose ka vonesa në njërin palë ose tjetrën, dhe kjo nuk po korrespondon me atë si duhet të jetë. Pra, për çdo aktivitet

minerar duhet të ekzistojë pëlqimi mjedisor nga Ministria e Mjedisit, e cila tregon që aktiviteti minerar nuk e dëmton ambientin. Shpërthimet të cilat bëhen me leje të KPMM-së kanë shkaktuar probleme anë e kënd Kosovës, kanë shkaktuar shqetësime te qytetarët por edhe te bizneset. Në këto tri çështje të fokusoheni shumë më shumë. Kemi raste kur kemi pas ankesa të qytetarëve edhe nëpër media që shpërthimet të cilat janë bërë nuk janë në harmoni me rregullat, respektivisht cenojnë sigurinë e banimit. Probleme kemi edhe te rrugët për shkak të shpërthimeve por edhe të lëvizjeve tektonike që shkaktohen nga këto shpërthime. Këto janë çështje që janë drejtpërdrejt të lidhura me ju. Keni dhënë licenca por edhe keni refuzua, do të ishte mirë të dimë mbi çfarë baze janë dhënë ato licenca apo janë refuzuar.

Blerim Grainca, e vlerësoi pozitivisht raportin, përmbajtjen e raportit, strukturën në përgjithësi. Ai theksoi se operatorët që shfrytëzojnë guroret janë të obliguar që ambientin ta kthejnë në gjendjen të cilën e kanë marrë, ndërsa situata aktuale kur shikohen ato kodrina ma shumë i ngjasojnë Afganistanit apo Kandaharit, apo ndonjë arene lufte sepse asnjë prej tyre nuk e ka kthyer në gjendje të mëparshme, as nuk i kanë mbuluar gropat e as nuk e kanë bërë gjelbërim. Z.Grainca përgëzoi KPMM-në për reagim në ndaljen e operimeve, të cilat mund të dëmtojnë Shpellën e Gadimes. Çështja e harmonizimit të ligjeve ende është problematike, siç duket nuk ka koordinim mes institucioneve, KPMM-së, Ministrisë së Mjedisit dhe Gjyqësorit. z.Grainca pyeti se a mjafton buxheti aktual për realizimin e objektivave të KPMM-së?

Sala Berisha-Shala, theksoi se raporti është i mirë, jo vetëm i shkruar mirë, por edhe puna që është bërë është e mirë. Lidhur me objektivat, ajo theksoi se operimet ilegale radhiten edhe si sfidë. Harmonizimi i kornizës organizative dhe ligjore shihet si çelësi i të gjitha problemeve tjera. Rritjen e investimeve të huaja do ta joshim me ngritjen e nivelit të shërbimeve për palët e treta, që edhe e keni radhitë si objektivë. Ajo potencoi se Kuvendi është në proces të miratimit të Ligjit për investimet strategjike, dhe do të duhej t'i identifikoni investitorët që vijnë apo janë këtu, investitorë serioz, që do të mund të vendosen në listën e investimeve strategjike. Ajo kërkoi më shumë sqarim, rreth sigurimit të resurseve minerale për gjeneratën e tashme dhe ruajtjen e qasjes në resurset natyrore edhe për gjeneratën e ardhshme, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Sfidë serioze është vërtetë mungesa e një objekti të përhershëm të punës. Paguani qira tash sa vite, dhe do të duhej të bëhej një zgjidhje. Një sfidë shumë e rëndësishme që është identifikua nga Zyra e Auditorit, kontrollin mbi menaxhimin e licencave, me theks të veçantë sigurimin e garancive bankare, që sipas juve Ligji i cili është momentalisht nuk e ofron një zgjidhje të dëshirueshme, pasi që me obligimet për garanci bankare dëmtohen edhe bizneset e operimit minerar.

Sasa Milosavljevic, pyeti se a është kjo agjenci që duhet të zbatojë ligjin për shërbyesit civilë dhe të zbatojë kuotën për pakicën dhe se a është zbatuar kuota?

Musa Shabani (KPMM), duke u përgjigjur, tha se në kohën e mungesës së Bordit, Trepça ka qenë e furnizuar me eksplozivë në atë periudhë, sa i përket Artanës është realizuar prodhimi edhe pse ka pasur mungesë licence, është lejua me një leje të posaçme të KFOR-it. Për Stan Tërg nuk mundem me ditë si ka qenë gjendja. Problemet në Trepçë kanë qenë për shkak të rënies së tregjeve botërore të metaleve. Operimet ilegale janë sfidë e madhe, KPMM-ja ka një inspektorat të vogël, inspektorët i gjejnë operuesit ilegalë, i ndërpresin operimet, i vendosin shiritat për ndalim të operimit, dhe i dërgojnë lëndët në Gjykatë. Jemi duke bashkëpunuar me

institucionet tjera dhe kemi hartuar një plan veprimi, që pritet të nënshkruhet nga Qeveria. Sa i përket vonesave apo mosharmonizimit me lejet mjedisore, KPMM-ja nuk lëshon asnjë licencë pa pëlqim mjedisor. Lidhur me shpërthimet, Ligji për miniera dhe minerale përcakton në mënyrë decisive distancat nga objektet, dhe KPMM-ja nuk ka lëshuar asnjë leje të vetme pa i respektuar ato distanca, ose në raste të caktuara kur nuk respektohen këto distanca, KPMM-ja është e detyruar të marrë pajtim nga çdo objekt që ka qenë brenda atyre distancave, që ka paraqit ndalesë. Kthimi në gjendjen e mëparshme është një problem, megjithatë secili operatorë që merr licencë është i obliguar ta ketë garancinë për rikultivimin e tokës, nëse nuk e bënë rikultivimin, i konfiskohet garancia. Sa i përket buxhetit, ka nevojë për buxhet, për personel shtesë për me godit më shumë operatorët ilegalë. KPMM-ja vazhdimisht është në ngritje të cilësisë së shërbimeve dhe nuk kemi pasur ankesa për cilësinë e shërbimeve. Garancia për rikultivim është ngarkesë për bizneset por jemi duke shikuar mundësinë që garancia të jetë më e butë, proporcionalisht me sipërfaqet e shfrytëzuara. Gjatë vitit 2015, KPMM-ja nuk ka punësuar asnjë person. Nga komunitetet është një inspektor në pjesën veriore, dhe një i komunitetit turk. Për vitin 2016 kemi edhe katër pozita të reja.

Fatmir Rexhepi, tha se duket që agjencia është mjaft e ngarkuar me personel. Nëse e shohim organogramin, vërehen dhjetë departamente, duhet ta dimë sa ka staf KPMM-ja dhe numri i stafit a është në pajtim me këtë veprimtari dhe mos të ngarkohet buxheti i Kosovës pa nevojë.

Musa Shabani (KPMM), tha se këtë strukturë të administratës e kemi gjetur kështu. KPMM-ja nuk është e ngarkuar me administratë, janë 71 punëtorë në KPMM, duke përfshi edhe anëtarët e bordit.

Azem Rexhaj (KPMM), theksoi domosdonë e harmonizimit të ligjeve, sepse është pengese reale për investitorët e huaj dhe kompanitë vendore, për shembull pamundësia që të marrë një pëlqim nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës për sipërfaqe më të madhe se 5 hektar dhe për afat më të gjatë se 5 vjet, kur dihet se investimet në miniera metalike janë dhjetëra apo qindra milionëshe, prandaj, harmonizimi i ligjeve në këtë pikë është i domosdoshëm. Kërkesa ligjore që garancitë për rehabilitim të nxjerrën nga banka është një pengesë shumë e madhe për zhvillimin e kompanive të vogla dhe te mesme, e veçanërisht atyre vendoreve, sepse po kërkohet nga kompanitë që ato të depozitojnë në banke shuma të mëdha parash apo hipoteka ende pa filluar punën.

Raif Qela, tha se e përmendët se ka probleme me harmonizim të ligjeve, siç u tha edhe nga dikush prej deputetëve që mund ti inicioni vet këto ndryshime, në atë mënyrë që ju i dini problemet më së miri, përqendrohni në të, i bëni si propozimet për ndryshime, ia ofroni Qeverisë, nëse për një afat të shkurtë Qeveria nuk iu përgjigjet, ky Komision është i gatshëm të fillojë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit në fjalë.

Pas debatit Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

I. Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2015, i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale – KPMM-ja, me rekomandimet si në vijim:

- *KPMM-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të ndërmerr aktivitete të mëtejme për të evituar shpërputhjet në ligjet e caktuara, e të cilat paraqiten pengesë në realizimin e detyrave dhe funksioneve të këtij aktiviteti rregullativ;*
- *KPMM-ja të informojë Komisionin, në lidhje me çështjet nga fusha e legjislacionit, të cilat duhet të harmonizohen me propozime konkrete;*
- *Të intensifikohen edhe me shumë aktivitetet për pengimin e operatorëve ilegalë dhe inkasimin e borxheve;*
- *Në raportet e ardhshme vjetore, sugjerohet që të ngritet niveli i analizës, lidhur me të arriturat dhe sfidat për rregullimin e këtij sektori dhe zhvillimin e tij të qëndrueshëm.*

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC, për vitin 2015;

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se e kemi parë raportin, një raport gjithëpërfshirës edhe të përgatitur mirë në aspektin teknik dhe përmbajtjesor. Gjithashtu raporti ka pasqyruar problemet dhe sfidat, dhe më pas ia kaloi fjalën z. Dritan Gjonbalaj, që të prezantojë shkurtimisht raportin.

Dritan Gjonbalaj, drejtor i AAC-së, tha se misioni i AAC-së është të krijojme një ambient të aviacionit, në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit. Sikurse edhe gjatë viteve paraprake, plani i punës edhe për vitin 2015, është bazuar në planin pesëvjeçar strategjik të AAC-së, duke i përcjell objektivat strategjike dhe duke i identifikuar objektivat e nevojshme vjetore, për përmbushjen e tyre strategjike. Funkzioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta, në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit dhe certifikimit. Ai potencoi se gjatë këtij viti janë realizuar këto aktivitete: rreth 50 inspektime të avionëve të huaj në platformë; 132 raporte të ndodhive, duke përfshirë 13 raporte të goditjes së shpendëve në avion dhe 42 raporte të ndriçimit të mjeteve ajrore me dritë laser; 68 leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit dhe janë certifikuar ofruesit e parë të trajnimeve për mallra të rrezikshme; licencimi i 12 pilotëve të aviacionit të përgjithshëm - deltaplan dhe paraglajd, testet teorike, praktike, kriteret mjekësore; mbikëqyrja e kalimit të shërbimeve të navigacionit ajror në objektin e ri; OSHNA ANP “Adem Jashari” – dy auditime gjithëpërfshirëse dhe një numër inspektimesh; vlerësimi i kompetencës profesionale të stafit; ripërtëritja e licencave për 30 kontrollorët; inspektime të shumta në ANP “Adem Jashari”; Operimet e aviacionit të përgjithshëm, miratimi dhe mbikëqyrja; ka vazhduar shënjimi dhe ndriçimi i të gjitha antenave, në përputhje me Rregulloren e AAC-së, duke përfshirë largpërçuesit e linjës së re 400 KV, në afërsi të Aeroportit të Gjakovës. Më tutje, ai potencoi se janë nxjerrë 14 rregullore për të

reflektuar zhvillimet e fundit legislative në rrafshin ndërkombëtar. Gjithashtu janë nxjerrë edhe një numër manualesh dhe materialesh udhëzuese, që burojnë nga këto rregullore. Me këto manuale lehtësohet implementimi i rregulloreve nga inspektorët tanë dhe nga entitetet e inspektuara. Gjonbalaj njoftoi se AAC-ja ka publikuar edhe një raport rreth gjendjes së 12 fushave ajrore në Republikën e Kosovës. AAC-ja ka bashkëpunuar me institucionet tjera të shtetit, për të garantuar një sistem rregullator funksional dhe të koordinuar mirë. AAC-ja ka përgatitur koncept dokumentet teknike dhe ligjore për anëtarësim në ICAO, ECAC dhe EUROCONTROL (MPJ), si dhe koncept dokumentin rreth aviacionit civil për ministren për Dialog. Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, ai potencoi se bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë me Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë, në fushën e inspektiveve dhe auditimeve të aviacionit civil, bashkëpunimi me Francën, përkrahje e vazhdueshme nga Franca. Kemi nënshkruar marrëveshje me Malin e Zi, me Turqinë, me Katarin. Me 3 prill 2014, është hapur hapësira e lartë ajrore e Kosovës për mbikalime. Në përputhje me vendimin e Këshillit të NATO-s, ofrimi i përkohshëm i shërbimeve në këtë hapësirë i është dhënë Hungaro Controlit, për një periudhë pesëvjeçare. Procesi vazhdon me normalizimin e plotë të hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, korridore të reja, aviacioni i përgjithshëm. Gjatë këtij viti priten aktivitete intensive në këtë drejtim. Korridoret e reja do ta shkurtojnë fluturimin për Prishtinë rreth 20 min. AAC-ja ende nuk arriti të hyjë në marrëveshje me Agjencinë Evropiane për Sigurinë e Aviacionit, megjithatë AAC-ja është në proces intensiv të angazhimit që sa më shpejtë të arrihet kjo marrëveshje, tha Gjonbalaj. Komisioni Evropian në një analizë krahasuese të Raporteve të Progresit 2014 të vendeve të rajonit, palë të Marrëveshjes HPEA, e rendit Kosovën të parën në listë për nga progresi në përmbushjen e kërkesave legislative të Fazës I (parë) të kësaj Marrëveshjeje. Në janar të këtij viti, AAC-ja ka organizuar në Prishtinë takimin e radhës së Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes ECAA. Sidoqoftë, vihen në pah disa çështje që pritet të adresohen prej nesh, siç është certifikimi i ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror si dhe fillimi i zbatimit të plotë të Ligjit mbi Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, theksoi Gjonbalaj. Lajm i mirë është se në vitin 2014 ka një ngritje prej 10.3% në numrin e udhëtarëve në ANP, krahasuar me vitin 2014. Korriku dhe gushti kanë pasur numrin më të madh të udhëtarëve. Rritja dyshifrore e numrit të udhëtarëve, rreth 20%, ka vazhduar edhe muajt e parë të këtij viti, potencoi në fund të fjalës së tij Gjonbalaj.

Raif Qela, tha se e kemi një raport shumë të përmbledhur, me mjaft detaje dhe si të tillë unë nuk kam asnjë vërejtje për këtë. Meqenëse është mjaft aktuale një ngjarje që ka ndodhur mbrëmë në Aeroportin e Prishtinës, pyes se rrëshqitja e avionit të “Turkish Airlines” nga pista në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, a ka qenë pasojë vetëm e kushteve atmosferike në përgjithësi dhe moskujdesi i pilotit, apo ka qenë çështje e cila nuk ka mundur të parashikohet, sipas asaj që nuk kanë qenë kushtet e volitshme në aeroport, qoftë pista e papastruar mjaft, qoftë sinjalizimi, e të tjera. Kjo për shkak se mund të ketë edhe mjaft shqetësime të qytetarët. Jam i vetëdijshëm se kjo çështje nuk i përket AAC-së, sepse është edhe Komisioni për hetimin e incidenteve dhe aksidenteve aeronautike pranë Zyrës së Kryeministrit, megjithatë përshtypjet e juaja të para, cilat janë, në mënyrë që qytetarët të jenë të njoftuar me kohë lidhur me këtë problem.

Fatmir Rexhepi, tha se raporti vjetor i AAC-së nuk është hera e parë që është ndër raportet më të mira që përgatitin agjencitë e pavarura që i raportojnë Kuvendit. Kemi pas rast ti kemi edhe raportet tjera, por sinqerisht them që raporti është për çdo vlerësim pozitiv. Po ashtu informata e

drejtorit që u tha këtu, ishte e kompletuar në nivel vërtetë të kënaqshëm, me të gjitha faktet dhe argumentet të cilat u paraqiten, të gjitha aktivitetet, të gjitha ato qofshin sfida qofshin punë të cilat i ka kryer Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Performanca e këtij autoriteti është e shkëlqyeshme dhe i jap përkrahjen e plotë, potencoi Rexhepi.

Blerim Grainca, e vlerësoi pozitiv këtë raport dhe qasjen e AAC-së me Komisionin. Sa herë që është kërkuar ndonjë informatë tregon se kemi një autoritet mjaft korrekt. Ju kisha inkurajuar që të bëni më shumë për anëtarësimin në mekanizmat evropianë, që është sfidë dhe synim kryesor. Aeroporti i Gjakovës sa është i arsyeshëm, çka po ndodh, a është i licencuar apo jo? Sa do të jetë në funksion ky aeroport kur dihet që disa kilometra është afër edhe aeroporti i Kukësit? Sa janë kompatibil, sa do të kenë performancë?

Kryetari, potencoi se ky Autoritet është shembull si duhet të jetë raporti dhe puna serioze. Të përqendrohemi në korridoret me vendet fqinje, do të thotë prej 12 korridoreve, 5 mund të shfrytëzohen tash. Shfrytëzohet vetëm ky me Maqedoninë, kjo është një çështje siç keni konstatua edhe ju, që ndikon në çmimin e biletave dhe kohën e fluturimit. Në këtë drejtim duhet të shohim çka mund të bëjmë së bashku që ta tejkalojmë këtë problem? Po rritet numri i udhëtarëve, por çka mund të ndikoni ju që çmimet e biletave nga Aeroporti i Prishtinës shpeshherë janë më të larta sesa nga aeroportet në vendet fqinje? Cili është roli i juaj që të ndikojë në këtë çështje?

Dritan Gjonbalaj, duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga deputetët, sqaroi se në rastin e mbrëmshëm të aeroplanit të “Turkish Airlines”, AAC-ja ka dërguar inspektorët e vet në aeroport. Për momentin nuk mund të jap informacionin përfundimtar, por mund të ndajë me ju të dhënat preliminare që i keni. Pista i plotëson kushtet sipas standardeve më të avancuara të Organizatës Evropiane të Aviacionit Civil. Në këtë rast piloti nuk ka arritur ta stabilizojë avionin për aterrim në kohën e duhur, dhe ka aterruar më larg sesa zona e aterrimit. Për shkak të aterrimit më larg në brendi të pistës, edhe për shkak të kushteve atmosferike, në kohë me shi kapaciteti i frenimit është më i vogël dhe duhet të jenë më të kujdesshëm, nuk ka arritur të frenojë me kohë dhe ka dalë jashtë pistës. Menjëherë janë evakuuar të gjithë pasagjerët, nuk ka pas lëndime, nuk ka dëme as në infrastrukturë. Ekipet e specializuara janë duke punuar për ta nxjerrë aeroplanin dhe në orën 13:00 pritet të hapet aeroporti për fluturime civile. Do të përpiqemi të përmirësojmë performancën, kemi pasur vështirësi të mëdha, para MSA-së, sepse agjencitë e specializuara kanë hezituar të hyjnë në aranzhime kontraktuale sektoriale, pa u nënshkruar “nëna” e të gjitha marrëveshjeve. Sa i përket Aeroportit të Gjakovës, AAC-ja është duke bërë një auditim, studim gjithëpërfshirës dhe shumë shpejt presim të dalim me rezultatet. Ky aeroport do të jetë në konkurrencë me Aeroportin e Kukësit. Lidhur me korridoret në hapësirën e ultë, në pjesën e dytë të këtij viti planifikojmë një seri të takimeve për hapjen e korridoreve të reja. Hapja e këtyre korridoreve ka edhe sfida politike, sidomos me Serbinë, ndërsa me Shqipërinë dhe Malin e Zi janë tërësisht sfida teknike. Në këtë sezon në treg janë futë edhe disa kompani të reja “low cost”, të shumtën e vitit biletat janë mjaft të lira, por shqetësimi është në kohën e pikut, gjatë sezonit.

Pas debatit Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

I. Të miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2015, i Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC, me rekomandimet si në vijim:;

- *Inkurajohet AAC-ja, që në bashkërenditje me të gjitha institucionet kompetente, të angazhohet për shfrytëzimin e korridoreve të ulëta ajrore, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës;*
- *AAC-ja të ndërmarrë masat e nevojshme nga fushëveprimi i vet për të krijuar një konkurrencë më të madhe midis operatorëve në funksion të uljes së çmimeve të udhëtimit, e sidomos në periudhën e pushimeve verore dhe dimërore.*

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

**5. Të ndryshme
Çështje vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa